



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Autoriteti i Aviacionit Civil
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva
Civil Aviation Authority

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Sipas nenit 21.3, nenit 61.2 dhe nenit 67 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil,

Me qëllim të rregullimit të sigurisë së aerodromeve në dispozicion për shfrytëzim publik në shërbim të operacioneve të transportit ajror të operatorëve ajrorë vendorë dhe ndërkombëtarë; dhe duke i caktuar kërkesat për certifikim, operim dhe mirëmbajtje të aerodromeve të tilla,

Nxjerr si në vijim:

RREGULLOREN Nr. 1/2008
MBI AERODROMET

Neni 1
Fushëveprimi

Kjo rregullore vlen për aerodromet që ofrojnë shërbime për operimet e transportit ajror të operatorëve ajrorë vendorë apo ndërkombëtarë.

Neni 2
Përkufizimet dhe interpretimet

Në këtë rregullore:

Aerodrom nënkupton zonën e përcaktuar në tokë apo ujë, duke i përfshirë të gjitha objektet, instalimet dhe pajisjet të cilat përdoren plotësisht apo pjesërisht në ardhje, shkuarje dhe në lëvizje të avionëve nëpër sipërfaqe.

Certifikatë e aerodromit nënkupton certifikatën e lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës në bazë të kësaj rregulloreje për operimin e një aerodromi .

Objektet dhe pajisjet e aerodromit nënkupton objektet dhe pajisjet brenda ose jashtë vijës kufizuese të aerodromit, që janë të ndërtuara apo të instaluar dhe mirëmbahen për ardhje, ngritje dhe për lëvizje të avionëve nëpër sipërfaqe.

Manual i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit nënkupton një manual që është pjesë e aplikacionit për certifikatë të aerodromit në bazë të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe të kësaj rregulloreje dhe përfshin çfarëdo ndryshimi që i bëhet Manualit e që pranohet nga AAC-ja.

Operatori i aerodromit nënkupton mbajtësin e certifikatës së aerodromit në lidhje me aerodromin e certifikuar.

Aneksi 14 nënkupton aneksin e “Aerodromeve: volumni 1” sipas Konventës së Çikagos.

Aneksi 13 nënkupton aneksin “Aksidenti i Aeroplanëve dhe Hetimi i Incidentit” sipas Konventës së Çikagos.

Aneksi 15 nënkupton aneksin “Shërbimet Informative të Aeronautikës” sipas Konventës së Çikagos.

Aneksi 4 nënkupton aneksin “Diagramet e Aeronautikës” sipas Konventës së Çikagos.

Platformë nënkupton një vend të caktuar në tokën e aerodromit, që ka për qëllim akomodimin e aeroplanëve për qëllime të hipjes apo zbritjes së pasagjerëve, ngarkimit e shkarkimit të postës apo mallit, mbushjes me derivate, parking apo mirëmbajtje.

AAC nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil në Kosovë.

Aerodrom i certifikuar nënkupton një aerodrom, operatorit të të cilit i është dhënë certifikata e aerodromit.

Konventa e Çikagos nënkupton bazën ndërkombëtare për marrëveshjet në aviacionin civil, që zyrtarisht njihet si Konventë mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

Operator i bazës statike nënkupton secilin person, firmë apo korporatë që ka bazë statike në aerodrom, që kryen funksione të aviacionit apo kryen shërbime të furnizimit në lidhje me aviacionin.

Zonë manovrimi nënkupton atë pjesë të aerodromit e cila do të shfrytëzohet për ngritje, aterrim dhe për taksim të avionëve, duke i përjashtuar platformat.

Shënjuesi nënkupton objektin që është mbi nivelin e tokës e që tregon ndonjë pengesë apo që paraqet një kufi.

Shënjimi nënkupton një simbol apo një grup të simboleve që janë në sipërfaqen e zonës së lëvizjes për të ofruar informata aeronautike.

Zonë e lëvizjes nënkupton atë pjesë të aerodromit që do të shfrytëzohet për ngritje, aterrim dhe për taksim të avionëve, që përbëhet prej zonës së manovrimit dhe platformës (ave).

Pengesë në lidhje me aerodromin nënkuptohen të gjitha objektet e fiksuara (qoftë përkohësisht apo përgjithmonë) apo pjesët e tyre, të cilat ndodhen në zonën e paraparë për lëvizjen sipërfaqësore të avionëve apo që ngrihen mbi sipërfaqen e definuar të paraparë për mbrojtjen e avionëve gjatë fluturimit.

Zonë e Lirë nga Pengesat (ZLP) në lidhje me aerodromin nënkupton hapësirën ajrore mbi sipërfaqen e brendshme të aterrimit, sipërfaqet e brendshme tranzicionale dhe sipërfaqen e aterrimit të penguar, si dhe mbi atë pjesë të brezit të pistës të kufizuar nga këto sipërfaqe, në të cilën nuk depërton asnjë pengesë e fiksuar përveç atyre me masë të vogël dhe me montim të thyeshëm, që kërkohen për nevojat e navigacionit ajror.

Sipërfaqet për Kufizim të Pengesave (SKP) nënkupton një seri sipërfaqesh që përcaktojnë madhësinë e hapësirës ajrore në dhe përreth aerodromit që duhet të mbahet e lirë, e kjo duhet bërë për të lejuar veprimtaritë e synuara të avionëve që të kryhen sigurt dhe për të parandaluar aerodromin të bëhet i pashfrytëzueshëm nga rritja e pengesave përreth aerodromit.

Shtegu i pistës nënkupton një vend të caktuar, duke përfshirë pistën dhe vendin e ndaljes, nëse ekziston, e që synon të:

- a) zvogëlojë rrezikun e dëmtimit të avionëve që ngrihen nga pista; dhe
- b) mbrojë avionët që fluturojnë mbi të gjatë veprimtarive të ngritjes apo aterrimit.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë nënkupton një sistem për menaxhimin e sigurisë nëpër aerodrome, duke përfshirë strukturën organizative, përgjegjësitë, procedurat, proceset dhe dispozitat për zbatimin e politikave të menaxhimit të sigurisë nga operatori i aerodromit, i cili ofron kontroll të sigurisë dhe shfrytëzim të sigurt, për aerodromin.

Brezi anësor i shtigjeve për taksim nënkupton një vend ku parashihet shtegu i taksimit që ka për qëllim të mbrojë një avion që operon në shteg të taksimit dhe të zvogëlojë rrezikun e dëmtimit të avionit, i cili aksidentalisht lëviz nëpër shteg të taksimit.

Zonë e papërdorshme nënkupton një pjesë të zonës së lëvizjes që është e papërshtatshme dhe e papërdorshme për t'u shfrytëzuar nga avioni.

Vendpunim nënkupton një pjesë të aerodromit ku punët e mirëmbajtjes apo ato të ndërtimit janë në zhvillim e sipër.

KAPITULLI 1 Certifikimi i aerodromit

Neni 3 Standardet e certifikimit

Çfarëdo referimi për standarde është referim ndaj standardeve të aerodromit ashtu siç janë në Aneksin 14, në këtë rregullore dhe në secilin standard tjetër të caktuar nga AAC-ja.

Neni 4 Kërkesa për certifikatë të aerodromit

4.1 Operatori i aerodromit që ka për qëllim operacionet e transportit ajror duhet të jetë në posedim të certifikatës së aerodromit, e cila i jepet në bazë të kësaj rregulloreje.

4.2 Operatori i një aerodromi, për të cilin nuk kërkohet certifikata e aerodromit, mund të aplikojë për certifikatë të aerodromit, për të cilën mund të kërkohet një tarifë.

Neni 5 Aplikimi për certifikatë të aerodromit

5.1 Aplikuesi mund të aplikojë për certifikatë të aerodromit pranë AAC-së, e cila e autorizon aplikuesin për të drejtuar aerodromin në vendin siç është saktësuar në aplikacion.

5.2 Aplikacioni duhet të jetë në formë të aprovuar dhe duhet të përfshijë Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit dhe tarifën e tilla, të cilat mund të përshkruhen nga autoriteti duhet të paguhet nga aplikuesi.

Neni 6 Dhënia e certifikatës së aerodromit

6.1 Varësisht nga dispozitat e nenit 6.2, AAC-ja mund të aprovojë aplikacionin dhe t'i japë certifikatë aerodromi aplikuesit.

6.2 Para se të japë certifikatë aerodromi, AAC-ja duhet të sigurohet se:

- a) Objektet e aerodromit, shërbimet dhe pajisjet janë në përputhje me standardet e Aneksit 14, të kësaj rregulloreje dhe me standardet e tjera të saktësuar nga AAC-ja;
- b) Procedurat vepruese të aerodromit i përmbushin dispozitat për sigurinë e avionëve;
- c) Themelimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të sigurisë;

d) Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit, i cili i përmban të gjitha informatat relevante të aerodromit të aplikuesit, të jetë përgatitur dhe dorëzuar në kuadër të dispozitave të kësaj rregulloreje;

e) AAC-ja sigurohet se aplikuesi do të jetë në gjendje të operojë e të mirëmbajë aerodromin në mënyrën e duhur.

Neni 7

Refuzimi i dhënies së certifikatës së aerodromit

Nëse AAC-ja refuzon dhënien e certifikatës së aerodromit, atëherë AAC-ja duhet t'i japë aplikuesit njoftim me shkrim në lidhje me refuzimin dhe me arsyet e saj jo më vonë se 14 ditë pas refuzimit të dhënies së certifikatës.

Neni 8

Pranimi i kushteve

8.1 AAC-ja mund të japë certifikatë të aerodromit duke vendosur kushte që janë të nevojshme në interes të sigurisë.

8.2 AAC-ja do t'i japë aplikuesit njoftim me shkrim për arsyet e çfarëdo kushti që vendoset në certifikatë.

Neni 9

Kohëzgjatja e certifikatës së aerodromit

9.1 Certifikata e aerodromit do të mbetet në fuqi 5 vjet nga data e lëshimit.

9.2 Mbajtësi i certifikatës së aerodromit do të paguajë tarifën e tilla për mirëmbajtje të certifikatës ashtu siç mund të përshkruhet nga AAC-ja.

Neni 10

Dorëzimi i certifikatës së aerodromit

10.1 Mbajtësi i certifikatës së aerodromit duhet t'i ofrojë njoftim me shkrim AAC-së jo më pak se 60 ditë për datën në të cilën certifikata duhet të dorëzohet me qëllim që të merret veprimi i duhur i shpalljes.

10.2 AAC-ja do ta anulojë certifikatën në datën e përcaktuar në njoftim.

Neni 11

Anulimi apo suspendimi i certifikatës së aerodromit

11.1 AAC-ja mund të suspendojë apo anuloj certifikatën e aerodromit nëse ka arsye për të besuar që:

a) Është shkelur kushti të cilit i nënshtrohet kontrata; apo

b) Objektet e aerodromit, operacionet apo mirëmbajtja nuk janë të një standardi të kërkuar në interes të sigurisë së navigimit ajror.

11.2 Para suspendimit apo anulimit të certifikatës së aerodromit, AAC-ja duhet t'i ofrojë mbajtësit një njoftim që i cek faktet dhe rrethanat të cilat paraqiten të arsyetojnë suspendimin apo anulimin dhe e fton mbajtësin t'i tregojë shkakun. Këtë e bën me shkrim dhe brenda një periudhe të arsyeshme, se pse certifikata nuk duhet të suspendohet apo të anulohet.

11.3 AAC-ja do të marrë parasysh çdo arsye që mbajtësi i ofron brenda kohës së lejuar para se të marrë ndonjë vendim për suspendim apo anulim.

11.4 Njoftimi për suspendim apo anulim hyn në fuqi në ditën kur i jepet mbajtësit të certifikatës së aerodromit.

Neni 12

Transferimi i certifikatës së aerodromit

12.1 AAC-ja duhet të japë pëlqimin dhe ta lëshojë një mjet për transferimin e certifikatës së aerodromit tek i transferuari kur:

- a) mbajtësi aktual i certifikatës së aerodromit e njofton AAC-në me shkrim së paku 60 ditë para se aerodromi të pushojë së funksionuari;
- b) mbajtësi aktual i certifikatës së aerodromit e njofton AAC-në me shkrim mbi emrin e transferuesit;
- c) transferuesi aplikon me shkrim pranë AAC-së brenda 45 ditëve para se mbajtësi aktual i certifikatës së aerodromit të pushojë së drejtuari aerodromin, në mënyrë që certifikata e aerodromit të transferohet tek i transferuari; dhe
- d) kërkesat e nenit 6.2 përmbushen.

12.2 Nëse AAC-ja nuk e jep pëlqimin për transferimin e certifikatës së aerodromit, AAC-ja duhet t'i japë aplikuesit njoftim me shkrim për refuzimin dhe për arsyet e refuzimit.

Neni 13

Ndryshimi i certifikatës së aerodromit

AAC-ja, me kusht që kërkesat e nenit 6.2, nenit 18 dhe nenit 19 të përmbushen, mund të ndryshojë certifikatën e aerodromit kur:

- a) ka ndryshim në operatorin e aerodromit;
- b) ka ndryshim në shfrytëzimin apo në operimet e aerodromit;
- c) ka ndryshim në kufijtë e aerodromit; apo

d) mbajtësi i certifikatës së aerodromit kërkon ndryshim.

KAPITULLI 2

Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit

Neni 14

Përgatitja e Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit

14.1 Operatori i aerodromit të certifikuar duhet të ketë një manual, që duhet të njihet si Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit, për aerodromin.

14.2 Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit do:

- a) të shkruhet apo shtypet dhe nënshkruhet nga operatori i aerodromit;
- b) të jetë në format që është lehtë i rishikueshëm;
- c) të ketë një sistem për të regjistruar ndërrimin e faqes dhe ndryshimet, përmes kësaj, dhe duhet të përfshijë një faqe për t'i regjistruar korrigjimet; dhe
- d) të jetë i organizuar në atë mënyrë që do të lehtësojë përgatitjen dhe procesin e rishikimit.

Neni 15

Vendndodhja e Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit

15.1 Operatori i aerodromit duhet t'ia sigurojë AAC-së një kopje complete dhe aktuale për Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

15.2 Operatori i aerodromit duhet të mbajë së paku një kopje complete dhe aktuale të Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit në aerodrom dhe, përveç kësaj, të paktën një kopje në vendin kryesor të biznesit të operatorit, nëse është vend i ndryshëm nga aerodromi.

15.3 Operatori i aerodromit të certifikuar duhet të mbajë kopjet e Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit, duke iu referuar nenit më lartë në një formë të shtypur.

15.4 Kopjet e tjera të Manualit mund të mbahen në kopje elektronike.

Neni 16

Informatat që duhen të përfshihen në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit

16.1 Operatori i aerodromit të certifikuar duhet të përfshijë hollësitë në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit siç është saktësuar në Aneksin për këtë rregullore; deri në atë shkallë që këto të jenë të aplikueshme për aerodromin.

16.2 Nëse AAC-ja e liron operatorin e aerodromit në bazë të nenit 33.1 nga përputhja me ndonjë kërkesë të caktuar në nenin 6.2, Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit duhet të tregojë numrin identifikues që jepet për lirim nga AAC-ja dhe datën kur lirimi ka hyrë në fuqi, dhe ndonjë kusht/procedurë sipas së cilës është dhënë lirimi.

16.3 Nëse ndonjë hollësi nuk përfshihet në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit ngase nuk është e aplikueshme për aerodromin, aerodromi duhet të cekë në Manual:

a) se hollësitë nuk janë të aplikueshme; dhe

b) arsyet për moszbatueshmësinë.

Neni 17

Rishikimi apo ndryshimi i informatave

17.1 Operatori i aerodromit të certifikuar duhet ta ndryshojë Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit kurdoherë që është e nevojshme e me qëllim që të mirëmbahet saktësia e Manualit.

17.2 AAC-ja mund t'i lëshojë udhëzime me shkrim operatorit të aerodromit për të ndryshuar Manualin në përputhje me udhëzimet, për të mirëmbajtur saktësinë e Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

Neni 18

Njoftimi mbi ndryshimet

Operatori i aerodromit duhet ta njoftojë AAC-në sa më shpejt që të jetë e mundur për çfarëdo ndryshimi që ai dëshiron ta bëjë në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

Neni 19

Pranimi i Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit nga AAC-ja

AAC-ja do ta pranojë Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit dhe çfarëdo ndryshimi të tij, me kusht që këto t'i përmbushin kërkesat e këtij kapitulli.

Neni 20

Kontrolli i Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit

Operatori i aerodromit të certifikuar duhet të caktojë një kontrollues të Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit. Detyrat e kontrolluesit të Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit janë që ai të sigurojë se:

a) një shënim i shpërndarjes të mbahet për secilën kopje të mbajtësit të Manualit tërësisht ose pjesërisht; dhe

b) përditësimet e Manualit t'u ofrohen në mënyrën e duhur të gjithë mbajtësve.

KAPITULLI 3

Obligimet e operatorit të aerodromit

Neni 21

Përputhja me standardet

21.1 Operatori i aerodromit do t'u përmbahet standardeve të dhëna në nenin 3 dhe me ndonjë kusht të pranuar në certifikatë në bazë të neneve 8.1 dhe 33.1.

21.2 Operatori i aerodromit të certifikuar duhet të sigurojë që operimet dhe mirëmbajtja e aerodromit të zbatohen me një shkallë të arsyeshme me kujdes dhe zell.

21.3 Operatori i aerodromit të certifikuar do të emërojë emrin dhe statusin e mbajtësve të pozitive që në vijim që i nënshtrohen pranimit nga AAC-ja: menaxheri përgjegjës (person i emëruar nga mbajtësi i certifikatës së aerodromit që ka përgjegjësi për të siguruar përputhje me kriteret e certifikatës); menaxheri për siguri (person përgjegjës për zbatimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë) dhe menaxheri për operime (person përgjegjës për operimet ditore në përputhje me Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit dhe në përputhje me rregulloren në fuqi).

21.4 Operatori i aerodromit do t'i bëjë të ditur emrat dhe statusin e personelit tjetër në pozita të larta që operojnë dhe udhëzohen sipas urdhrin dhe rrethanave në të cilat ata mund të kërkohen të operojnë.

Neni 22

Kompetenca e personelit operativ dhe të mirëmbajtjes

22.1 Operatori i aerodromit do të punësojë personelin e duhur të kualifikuar dhe të shkathët për të kryer të gjitha aktivitetet e rëndësishme në veprimtarinë e aerodromit dhe në proceset e mirëmbajtjes.

22.2 Kur AAC-ja apo ndonjë autoritet tjetër kompetent t'i ketë përshkruar kërkesat e kompetencës së certifikatës për personelin e referuar në nenin 22.1, operatori i aerodromit do të punësojë vetëm ata persona të cilët i kanë certifikatat e tilla.

22.3 Operatori i aerodromit do të zbatojë programin për të mirëmbajtur dhe përmirësuar kompetencën e personelit që referohet në nenin 22.1.

Neni 23

Operimi i aerodromit dhe mirëmbajtja

23.1 Varësisht prej ndonjë udhëzimi që AAC-ja mund të nxjerrë, operatori i aerodromit do të drejtojë dhe mirëmbajë aerodromin në përputhje me procedurat e cekura në Manualin e shërbimeve dhe operimeve të aerodromit.

23.2 Për të mundësuar sigurinë e avionëve, AAC-ja mund t'i japë udhëzime të shkruara operatorit të aerodromit për të ndryshuar procedurat e cekura në Manualin e shërbimeve dhe operimeve të aerodromit.

23.3 Operatori i aerodromit do të sigurojë mirëmbajtje të duhur dhe efikase për objektet e aerodromit.

Neni 24

Sistemi i menaxhimit të sigurisë i operatorit të aerodromit

24.1 Operatori i aerodromit do të themelojë një sistem të menaxhimit të sigurisë për aerodromin, duke përfshirë strukturën e organizatës dhe detyrat, fuqitë dhe përgjegjësitë e zyrtarëve në strukturën organizative, me synim që të sigurojë që operimet të zbatohen në një mënyrë demonstrative të kontrolluar dhe të përmirësohen aty ku është e nevojshme.

24.2 Operatori i aerodromit do t'i obligojë të gjithë shfrytëzuesit e aerodromit duke i përfshirë edhe operatorët me bazë fikse, që sa i përket trajtimit të fluturimit dhe avionëve të kryejnë aktivitetet e tyre në aerodrom në mënyrë të pavarur, kjo për t'iu përmbajtur kërkesave të parashtruara nga operatori i aerodromit në lidhje me sigurinë dhe urdhrin e aerodromit, dhe do të monitorojë përputhshmërinë me këto kërkesa.

24.3 Operatori i aerodromit do t'i obligojë të gjithë shfrytëzuesit e aerodromit, duke e përfshirë edhe operatorin e bazës fikse dhe organizatat që i referohet neni 24.2 për të bashkëpunuar në program për të avancuar siguri në aerodrom dhe përdorim të sigurt të aerodromit, në mënyrë që menjëherë të informohet operatori i aerodromit për aksidentet, incidentet, defektet dhe gabimet që kanë ndikim në siguri.

Neni 25

Auditimet e brendshme të sigurisë dhe raportimi i sigurisë nga ana e operatorit të aerodromit

25.1 Operatori i aerodromit do të kryejë një auditim të sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë një inspektim të objekteve dhe pajisjeve të aerodromit. Auditimi do të përfshijë detyrat e vetë operatorit të aerodromit.

25.2 Auditimet të cilave u referohet neni 25.1 do të zbatohen çdo 12 muaj apo më pak, ashtu siç do të pajtohet me AAC-në.

25.3 Operatori i aerodromit do të sigurojë se raportet e auditimit, duke përfshirë raportin mbi objektet, shërbimet dhe pajisjet e aerodromit përgatiten nga ekspertë të sigurisë me kualifikim të përshtatshëm.

25.4 Operatori i aerodromit do të mbajë një kopje të raportit (ëve) të cilit i referohet neni

25.3 për një periudhë dyvjeçare. Një kopje të këtij raporti të auditimi operatori i aerodromit do t'ia dorëzojë AAC-së.

25.5 Raportet të cilave u referohet neni 25.3 duhet të përgatiten dhe të nënshkruhen nga persona të cilët kanë kryer auditime dhe inspektime.

Neni 26 Qasja në aerodrom

26.1 Personeli i autorizuar nga AAC-ja mund të inspektojë dhe të bëjë teste në objektet, shërbimet dhe në pajisjet e aerodromit, të inspektojë dokumentet dhe shënimet e operatorit të aerodromit dhe të verifikojë sistemin e menaxhimit të sigurisë së operatorit të aerodromit para se të jepet apo të ripërtërihet certifikata e aerodromit dhe më pas, në çfarëdo kohe tjetër, për qëllim të ofrimit të sigurisë dhe rendit në aerodrom.

26.2 Operatori i aerodromit sipas kërkesës së personit që i referohet neni 26.1 do të lejojë qasje në secilën pjesë të aerodromit apo në secilin objekt të aerodromit, duke përfshirë pajisjet, shënimet, dokumentet dhe personelin e operatorit për qëllim referimi nga neni 26.1.

26.3 Operatori i aerodromit do të bashkëpunojë për të zbatuar aktivitetet të cilave u referohet neni 26.1.

Neni 27 Njoftimi dhe raportimi

27.1 Operatori i aerodromit do t'u përmbahet kërkesave të njoftimit dhe të raportimit brenda afateve kohore të caktuara AAC-së, kontrollit të trafikut ajror dhe pilotëve ashtu siç e kërkon kjo rregullore.

27.2 Operatori i aerodromit do të rishikojë çështjet e Publikimit Informativ Aeronautik (PIA), Aneksit të PIA-së, Ndryshimet e PIA-së, Njoftimin për Pilot (NP), Buletinin Informativ para nisjes së avionit dhe Qarkoret Informative Aeronautike të lëshuara nga Shërbimi Informativ Aeronautik (SHIA) me pranimin e tyre, dhe nga kjo, e menjëherë pas rishikimeve të tilla, do ta njoftojë SHIA-në për çfarëdo informate të gabueshme që ekziston aty e që i përket aerodromit.

27.3 Operatori i aerodromit do t'i njoftojë SHIA-në dhe AAC-në me shkrim së paku 60 ditë para ndonjë ndryshimi në objektet dhe në pajisjet e aerodromit apo në nivelin e shërbimit në aerodrom, që është planifikuar paraprakisht e që ka të ngjarë të ndikojë në saktësinë e informatave që mund të jenë në ndonjë publikim të SHIA-së, të cilit i referohet neni 27.2.

27.4 Varësisht nga kërkesat e neni 27.5, operatori i aerodromit do t'i japë SHIA-së dhe do të ndikojë që të pranohet në kontrollin e trafikut ajror dhe në njësinë e operimeve të

fluturimit njoftimi i menjëhershëm, duke dhënë hollësi për ndonjë për rrethanat në vijim për të cilat operatori ka njohuri:

a) pengesat, bllokimet dhe rreziqet:

i) ndonjë ngritje të ndonjë objekti nëpërmjet sipërfaqes me pengesë të kufizuar në lidhje me aerodromin; dhe

ii) ekzistimi i ndonjë bllokimi apo gjendjeje të rrezikshme që prek sigurinë e aviacionit në apo afër aerodromit;

b) niveli i shërbimit:

i) zvogëlim në nivelin e shërbimit në aerodrom që është parashtruar në publikimet e SHIA-së, që referohet në nenin 27.2.

c) zona e lëvizjes:

i) mbyllja e ndonjë pjese të zonës së lëvizjes të aerodromit; dhe

d) çfarëdo kushti tjetër që mund të prekë sigurinë e aviacionit në aerodrom dhe kundër të cilave jepen paralajmërimet.

27.5 Kur nuk është e mundshme që operatori i aerodromit të japë njoftim për rrethanën e referuar në nenin 27.4 që duhet të pranohet në kontrollin e trafikut ajror apo në njësinë e operacioneve të fluturimit në përputhje me atë rregullore, operatori duhet t'i japë njoftim të menjëhershëm pilotit, i cili mund të preket nga ajo rrethanë.

Neni 28 Inspektimet speciale

Operatori i aerodromit do të inspektojë apo aranzhojë inspektimin për aerodrom sipas kërkesës së rrethanave, duke ofruar sigurinë e aviacionit:

a) sa më shpejt të jetë e mundshme, pas aksidentit të avionit apo incidentit në kuptimin e këtyre termeve të caktuara në ICAO, Aneksi 13 dhe në procedurat shtetërore për njoftimin dhe lajmërimin e aksidenteve dhe incidenteve;

b) gjatë ndonjë periudhe të ndërtimit apo riparimit të objekteve apo pajisjeve të aerodromit, që janë të domosdoshme për veprimtarinë e sigurisë së avionëve; dhe

c) në ndonjë kohë tjetër kur ka kushte në aerodrom që mund të ndikojnë në sigurinë e aviacionit.

Neni 29 Largimi i pengesës nga sipërfaqja e aerodromit

Operatori i aerodromit do të largojë apo do të aranzhojë që të largohen pengesat e tjera nga sipërfaqja e aerodromit apo ndonjë automjet që ka të ngjarë që është i rrezikshëm.

Neni 30 Njoftimet paralajmëruese

Kur avionët me fluturim të ulët, në apo afër aerodromit, apo avionët që ecin ngadalë para ngritjes kanë të ngjarë të jenë të rrezikshëm për njerëzit apo për trafikun e automjeteve, operatori i aerodromit do të:

- a) postojë njoftime duke paralajmëruar për rrezikun në ndonjë rrugë publike që është afër zonës së manovrimit; apo
- b) nëse ajo rrugë publike nuk kontrollohet nga operatori i aerodromit, duhet t'i lajmërojë autoritetet përgjegjëse për të postuar njoftime në rrugën publike, duke treguar se ekziston rrezik.

Neni 31 Mbajtja e shënimeve

Mbajtësi i certifikatës së aerodromit do të themelojë dhe mbajë trajnim për personel dhe shënimet e inspektimit.

Neni 32 Ofrimi i shërbimeve të tjera

Operatori i aerodromit do të ndihmojë kryerjen e funksioneve të autoriteteve të tjera përgjegjëse për kontroll të trafikut, imigrim, dogana, shëndetësi dhe shërbime të tjera.

Neni 33 Lirimet

33.1 AAC-ja mund të lirojë me shkrim operatorin e aerodromit nga përputhja me dispozitat e caktuara të kësaj rregulloreje.

33.2 Para se AAC-ja të vendosë të lirojë operatorin e aerodromit, AAC-ja duhet të marrë parasysh të gjithë faktorët relevantë në lidhje me interesin e sigurisë.

33.3 Lirimi i nënshtrohet operatorit të aerodromit, i cili u përmbahet kushteve/procedurave të caktuara nga AAC-ja në certifikatën e aerodromit si e nevojshme në interes të sigurisë.

33.4 *Kur aerodromi nuk e përmbush kërkesën e standardit të caktuar në nenin 3, AAC-ja mund të vendosë, pas rishikimit të ndonjë studimi aeronautik, i cili është kryer nga operatori i aerodromit, vetëm nëse edhe aty ku është i lejuar sipas standardeve ato kushte dhe procedura në lidhje me standardet pasi janë të nevojshme për të ofruar një nivel sigurie ekuivalent me atë të vendosur sipas standardit.*

33.5 Shmangia nga standardi dhe kushtet, si dhe procedurat e referuara në nenin 8.1 do të parashtrihen me vërtetim në certifikatën e aerodromit apo me shkrim. Nëse lirimi jepet me shkrim, ai do të përfshihet në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi më 27 nëntor 2008.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil

Aneksi

Hollësitë që do të përfshihen në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit

Pjesa 1 Të përgjithshme

Informatat e përgjithshme përfshijnë si në vijim:

- a) qëllimi dhe fushëveprimi i Manualit;
- b) kërkesat ligjore për të gjitha certifikatat e aerodromit dhe Manualin, siç është parashkruar në rregulloret nacionale;
- c) kushtet për shfrytëzimin e aerodromit – një formulim për të treguar se aerodromi në të gjithë kohën, kur është në dispozicion për ngritje dhe aterime të avionëve, do të jetë në dispozicion për të gjithë personat me kushte dhe kondita të njëjta;
- d) emri dhe statusi i menaxherit përgjegjës (personi i emëruar nga mbajtësi i licencës së aerodromit me përgjegjësi për ofrimin e përputhjes me kriteret e certifikatës); menaxheri për siguri (personi përgjegjës për zbatimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë) dhe menaxheri i operimeve (personi përgjegjës për operacionet ditore në përputhje me Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit dhe me rregulloren në fuqi);
- e) emrat dhe statusin e personelit tjetër të lartë që operojnë në aerodrom dhe udhëzimet sipas urdhrit dhe rrethanave në të cilat ato mund të kërkohen për të vepruar;
- f) sistemi i informatave aeronautike në dispozicion dhe procedurat për shpalljen e tyre;
- g) sistemi për regjistrimin e lëvizjes së avionit; dhe
- h) obligimet e operatorit të aerodromit.

Të dhënat mbi pozitën e aerodromit

Informatat e përgjithshme si në vijim:

- a) plani i aerodromit që tregon objektet kryesore të aerodromit për funksionimin e aerodromit duke përfshirë, në veçanti, vendndodhjen e secilit indikator të drejtimit të erës;
- b) plani i aerodromit që tregon kufijtë e aerodromit;
- c) plani që tregon distancën e aerodromit nga qyteti më i afërt, apo ndonjë zonë tjetër e populluar dhe vendndodhjen e ndonjë objekti dhe pajisjeve të aerodromit jashtë kufijve të aerodromit; dhe
- d) të dhënat e emrit të
 - i. vendndodhjes së aerodromit apo
 - ii. nëse kufijtë e aerodromit nuk janë të përcaktuar në dokumente me të dhënat e emrit, në të dhëna apo në interes të pronës ku është vendosur aerodromi dhe planit i cili tregon kufijtë dhe pozitën e aerodromit.

Pjesa 3

Të dhënat e aerodromit që kërkohen t'i raportohen Shërbimit Informativ Aeronautik (SHIA)

3.1 Informatat e përgjithshme:

- a) emri i aerodromit;
- b) vendndodhja e aerodromit;
- c) koordinatat gjeografike të Pikës Referuese të Aerodromit që përcaktohen prej Sistemit Botëror Gjeodezik – 1984 (ËGS - 84) data e referimit;
- d) lartësia mbidetare e aerodromit dhe ndryshimet magnetike;
- e) lartësia mbidetare e secilit prag dhe ndryshimet magnetike, lartësia e brezit skajor të pistës dhe ndonjë pikë e rëndësishme e lartë dhe e ulët përgjatë pistës, dhe lartësia më e lartë e zonës së aterimit për qasjen precize në pistë;
- f) temperatura referente e aerodromit;
- g) hollësitë e shenjës sinjalizuese të aerodromit; dhe

h) emri i operatorit të aerodromit dhe adresa e numrat e telefonit ku operatori i aerodromit mund të kontaktohet gjatë gjithë kohës.

3.2 Dimensionet e aerodromit dhe informatat e ngjashme

Informatat e përgjithshme që përfshijnë si në vijim:

- a) pista – ndikimi i vërtetë, numri i emërimit, gjatësia, gjerësia, vendndodhja e pragut të zhvendosur, pjerrësia, lloji i sipërfaqes, lloji i pistës, dhe ekzistenca e pengesës së zonës së lirë për qasjen precize në pistë;
- b) gjatësia, gjerësia dhe lloji i sipërfaqes së shtegut, skajet e sigurta të zonës së pistës, vendndalimet;
- c) gjatësia, gjerësia dhe lloji i sipërfaqes së vendit të shtegut të qarkullimit;
- d) lloji i sipërfaqes së platformës dhe vendqëndrimet e avionëve;
- e) gjatësia e rrugës ku ndalohet qëndrimi dhe profili i tokës;
- f) ndihmat vizuale për procedurë të qasjes d.m.th lloji i qasjes së ndriçimit dhe qasja vizuale e sistemit të treguesit të pjerrësisë (PAPI/APAPI dhe T-VASIS/AT-VASIS); shënjimi dhe ndriçimi i pistave, vendqëndrimeve dhe platformave; udhëzimet e tjera vizuale dhe ndihmat e kontrollit në vendqëndrime (duke përfshirë pozitat e pistave, pozitat e ndërmjetme dhe pengesë-ndalesat) dhe platformat, vendndodhja e lloji i sistemit udhëzues vizual për ankorim; disponueshmëria e fuqisë në ndriçimit në pritje;
- g) vendndodhja dhe radiofrekuencat e VOR pikës kontrolluese të aerodromit;
- h) vendndodhja dhe emërtimi i rrugës standarde të taksimit;
- i) koordinatat gjeografike të secilit prag;
- j) koordinatat gjeografike të qendrës së përshtatshme të taksimit të pikave të rreshtit;
- k) koordinatat gjeografike të secilit vendqëndrim të avionit;
- l) koordinatat gjeografike dhe top-lartësia e pengesave domethënëse në zonën e qasjes dhe ngritjes, në zonën qarkulluese dhe në afërsi të aerodromit. (Kjo informatë më së miri mund të tregohet në formë të diagrameve siç janë ata që kërkohen për përgatitjen e publikimeve informative aeronautike që janë dhënë në Aneksit 4 dhe 15 në Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar);
- m) lloji i shtresës dhe forca ndikuese, duke përdorur metodën e numrit të klasifikimit të avionit – numrit të klasifikimit të shtresës (ACN - PCN);

n) lokacionin e një apo më shumë kontrolleve të lartësimatësit të parafluturimit të vendosur në platformë apo në lartësinë e tyre;

o) distancat e deklaruara; distanca e mjaftueshme për ngasje para ngritjes (TORA); distanca e mjaftueshme për ngritje (TODA); distanca e mjaftueshme për përshpejtim-ndalje (ASDA); distanca e mjaftueshme për aterrim (LDA);

p) të dhënat dhe mënyra e kalkulimit të distancës dhe lartësisë së deklaruar në fillim dhe në fund të secilës distancë të deklaruar;

q) metoda e kalkulimit të distancave të zvogëluara të deklaruara dhe procedura për shpalljen e tyre;

r) plani për largimin e avionëve të paaftë; numrat e telefonit, telefaksit, faksimilet, e-mail adresa e koordinatorit të aerodromit për largimin e avionëve të paaftë në apo afër zonës së lëvizjes; informata mbi mundësinë për të larguar avionët e paaftë – sa u përket avionëve të cilët aerodromi është i pajisur për t'i larguar; dhe

s) shpëtimi dhe zjarrfikja: niveli i mbrojtjes i ofruar, i shprehur në lidhje me kategorinë e shërbimeve të shpëtimit dhe zjarrfikjes, që duhet të jetë në përputhje me avionët më të gjatë që normalisht e shfrytëzojnë aerodromin dhe gjerësinë e tyre të trupit të avionit dhe llojin e shumën e mjeteve të zjarrfikjes që normal janë në dispozicion në aerodrom. Niveli i mbrojtjes që ofrohet nuk duhet të jetë më pak se një kategori nën kategorinë e caktuar.

Pjesa 4

Të dhënat e procedurave operative të aerodromit dhe masat e sigurisë

4.1 Raportimi në aerodrom

Të dhënat e procedurave për raportimin e ndonjë ndryshimi në informatat e aerodromit që janë përcaktuar në AIP dhe procedurat për të kërkuar çështjen e NOTAMS-it, duke përfshirë:

a) marrëveshjet për raportimin e ndonjë ndryshimi tek AAC-ja dhe regjistrimin e raportimit të ndryshimeve gjatë dhe jashtë orarit normal të detyrave të aerodromit;

b) emrat dhe rolet e personave përgjegjës për t'i dhënë numrat e tyre të telefonit gjatë dhe jashtë orarit të aerodromit dhe vendndodhjen e numrave të telefonit, siç është dhënë nga AAC-ja, të vendit, ku ndryshimet duhet të raportohen në AAC.

4.2 Qasja në zonën e lëvizjes së aerodromit

Të dhënat e procedurave të hartuara dhe të përcjelljes së tyre në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për të parandaluar ndërhyrjen e paligjshme në aviacionin civil në aerodrom, për të parandaluar hyrjen e paautorizuar të personave, automjeteve, pajisjeve, kafshëve dhe gjësendeve të tjera në zonën e lëvizjes, duke përfshirë:

a) rolin e operatorit të aerodromit, operatorit të avionëve, operatorëve me bazë fikse në aerodrom, njësisë së sigurisë së aerodromit, AAC-së dhe departamenteve të tjera qeveritare, siç janë të zbatueshme; dhe

b) emrat dhe rolet e personelit përgjegjës për të kontrolluar qasjen në aerodrom dhe numrat e telefonit për t'i kontaktuar ata gjatë dhe pas orarit të punës.

4.3 Plani emergjent i aerodromit

Të dhënat e planit emergjent të aerodromit, duke përfshirë si në vijim:

a) planet për t'u marrë me emergjencat që ndodhin në aerodrom apo në afërsi të aerodromit, duke përfshirë prishjen e avionëve gjatë fluturimit, zjarret strukturore, sabotimin, kërcënimin me bombë (ndaj avionëve apo strukturës), kapjen e paligjshme të avionëve dhe incidente në aerodrom që përfshijnë faktorët “gjatë emergjencave” dhe “pas emergjencave”;

b) hollësitë e testeve për objektet e pajisjet e aerodromit që do të shfrytëzohen për emergjenca, duke përfshirë frekuencën e këtyre testeve;

c) hollësitë e ushtrimeve për t'i testuar planet e emergjencave, duke përfshirë frekuencën e këtyre ushtrimeve;

d) marrëveshjet për rishikimin e frekuencave të këtyre ushtrimeve;

e) lista e organizatave, agjencive dhe personave me autoritet edhe në aeroport edhe jashtë tij për rolet në terren; numrat e tyre të telefonit, telefaksit dhe adresa e e-mailit, SITA drejtoria e kodit dhe radio-frekuencat e zyrave;

f) themelimi i përgatitjeve të komisionit emergjent të aerodromit për t'u marrë me emergjenca; dhe

g) emërimi i një komandanti në vendin e ngjarjes për operacionin e përgjithshëm emergjent.

4.4 Shpëtimi dhe zjarrfikja

Të dhënat e objekteve, pajisjet, personeli dhe procedurat për t'i përmbushur kërkesat e shpëtimit dhe zjarrfikjes, duke përfshirë emrat dhe rolet e personave përgjegjës për t'u marrë me shërbimet e shpëtimit dhe zjarrfikjes në aerodrom.

4.5 Zona e lëvizjes në aerodrom dhe inspektimi i sipërfaqes me pengesa të kufizuara nga operatori i aerodromit.

Të dhënat e procedurave dhe inspektimi i zonës së lëvizjes së aerodromit dhe sipërfaqeve me pengesa kufizuese, duke përfshirë si në vijim:

- a) marrëveshjet për t'i kryer inspektimet, duke përfshirë fërkimet e pistës dhe matjen e thellësisë së ujit në pistë dhe në vendqëndrimin e avionëve gjatë dhe jashtë orarit të operimit të aerodromit;
- b) aranzhimet dhe mjetet e komunikimit me Kontrollin e Trafikut Ajror gjatë inspektimit;
- c) marrëveshjen për të mbajtur një libër-regjistër të inspektimit dhe vendndodhja e libër-regjistrit;
- d) hollësitë e intervaleve dhe kohës së inspektimit ;
- e) lista e kontrollit të inspektimit;
- f) marrëveshja për të raportuar rezultatet e inspektimit dhe për të ndërmarrë veprime të menjëhershme të përcjelljes për të siguruar korrigjim të kushteve të pasigurta; dhe
- g) emrat dhe rolet e personave përgjegjës për të kryer inspektimet dhe numrat e tyre të telefonit gjatë dhe jashtë orarit të punës.

4.6 Ndryshimi dhe sistemi elektrik i aerodromit

Të dhënat e procedurave për inspektim dhe mirëmbajtje të dritave aeronautike (duke përfshirë ndryshimin e pengesës), shenjat, shënjeshtat dhe sistemin elektrik, duke përfshirë si në vijim:

- a) marrëveshja për të kryer inspektime gjatë dhe jashtë orarit normal të operimeve të aerodromit dhe lista e kontrollit për inspektime;
- b) marrëveshja për regjistrimin e rezultatit të inspektimit dhe për të ndërmarrë veprim përcjellës për t'i korrigjuar gabimet;
- c) marrëveshja për të kryer mirëmbajtje rutine dhe mirëmbajtje emergjente;
- d) marrëveshja për furnizime sekondare me rrymë, nëse është e aplikueshme, dhe ndonjë e dhënë për ndonjë metodë tjetër për t'u marrë me rënien e sistemit total apo të pjesshëm;
- e) emrat dhe rolet e personave përgjegjës për inspektim dhe mirëmbajtje të ndryshimit dhe numrat e telefonave për t'i kontaktuar ata gjatë dhe jashtë orarit të punës.

4.7 Mirëmbajtja e zonës së lëvizjes

Të dhënat e godinave dhe procedurat për mirëmbajtjen e zonës së lëvizjes, duke përfshirë si në vijim:

- a) marrëveshja për mirëmbajtjen e zonave të shtruara;
- b) marrëveshja për mirëmbajtjen e pistave dhe vendqëndrimeve të pashtuara;
- c) marrëveshja për mirëmbajtjen e shtigjeve të pistës dhe vendqëndrimeve; dhe
- d) marrëveshja për mirëmbajtjen e drenazhit të aerodromit.

4.8 Siguria e punës në aerodrom

Të dhënat e procedurave për planifikim dhe kryerjen e detyrave në mënyrë të sigurt (duke përfshirë punët që mund të kryhen me një afat të shkurtër lajmërimi) apo në afërsi të zonës së lëvizjes, që mund të dalë jashtë sipërfaqes së kufizimit të pengesës, duke përfshirë si në vijim:

- a) marrëveshja për komunikim me Kontrollin e Trafikut Ajror gjatë mbarëvajtjes së punëve të tilla;
- b) emrat, numrat e telefonit dhe rolet e personave përgjegjës dhe organizata përgjegjëse për planifikim dhe për kryerjen e punëve, si dhe marrëveshja për t'i kontaktuar ata persona e organizata gjatë gjithë kohës;
- c) emrat e operatorëve të aerodromit të bazës fikse dhe operatorët e avionëve, që duhet të njoftohen për punën, dhe numrat e tyre të telefonit gjatë dhe pas orarit të punës; dhe
- d) lista e shpërndarjes së planeve të punës, nëse kërkohet.

4.9 Menaxhimi i platformës

Të dhënat e procedurave për menaxhimin e platformës:

- a) marrëveshja në mes të Kontrollit të Trafikut Ajror dhe Njësisë për menaxhimin e platformës;
- b) marrëveshja për të ndarë pozitat e parkimit të avionëve;
- c) marrëveshja për inicimin e ndezjes së motorit dhe sigurimin e hapësirës për kthimin e avionit;
- d) organizimi i shërbimeve; dhe
- e) shërbimi i udhëheqësit.

4.10 Menaxhimi i sigurisë së platformës

Procedura për të siguruar sigurinë e platformës përfshin:

- a) mbrojtjen nga shpërthimet e motorëve;
- b) zbatimin e masave të sigurisë gjatë operacioneve të rimbushjes/zbrazjes së avionit;
- c) fshirja e platformës;
- d) pastrimi i platformës;
- e) marrëveshja për të raportuar incidentet,aksidentet në platformë; dhe
- f) marrëveshja për auditimin e tërë personelit që punon në platformë se a i përmbahet sigurisë.

4.11 Kontrolli i automjeteve në zonat ajrore

Të dhënat e procedurave për kontrollin e automjeteve që operojnë në, apo në afërsi të zonës së lëvizjes, duke përfshirë si në vijim:

- a) hollësitë e rregullave të aplikueshme në trafik (duke përfshirë kufizimin e shpejtësisë dhe mënyrat e zbatimit të rregullave); dhe
- b) mënyra e lëshimit të licencave të ngasjes për automjetet vepruese në zonën e lëvizjes.

4.12 Menaxhimi i rrezikut nga shtazët

Të dhënat e procedurave për t'u marrë me rrezikun e operacioneve të avionëve që shkaktohet nga prezenca e zogjve apo gjitarëve në strukturën apo në zonën e lëvizjes së fluturimit në aerodrom, duke përfshirë;

- a) marrëveshjen për vlerësimin e rrezikut nga ndonjë shtazë;
- b) marrëveshjen për zbatimin e programeve të kontrollit ndaj shtazëve; dhe
- c) emrat dhe rolet e personave përgjegjës për t'u marrë me rreziqet nga shtazët dhe numrat e tyre të telefonit gjatë dhe pas orarit të punës.

4.13 Kontrolli i pengesës

Të dhënat që përcaktojnë procedurat:

- a) monitorimi dhe regjistrimi i pengesave të cilat shkelin sipërfaqet me pengesa të kufizuara, përshkrimin e tyre, lartësinë dhe vendndodhjen dhe ndriçimin e tyre;
- b) monitorimi i sipërfaqes së kufizimit të pengesës dhe Lloji A i Diagramit i sipërfaqes së ngritjes për pengesa;

- c) kontrollimi i pengesave në kuadër të autoritetit të operatorit;
- d) monitorimi i ndërtesave apo zhvillimit të strukturës në lidhje me lartësinë e tyre në suaza të kufijve të sipërfaqeve me pengesa të kufizuara;
- e) kontrolli i zhvillimeve të reja në afërsi të aerodromeve; dhe
- f) njoftimi i AAC-së për natyrën dhe vendndodhjen e pengesave dhe ndonjë shtesë tjetër apo largim të pengesave për ndryshim të nevojshëm, duke përfshirë ndryshimet e publikimeve të SHIA-së.

4.14 Plani dhe procedurat e largimit të avionëve të paaftë

Të dhënët e procedurës për largimin e avionit që është prishur në apo në afërsi të zonës së lëvizjes, duke përfshirë si në vijim:

- a) rolet e operatorit të aerodromit dhe mbajtësit të regjistrimit të avionëve;
- b) marrëveshja për të njoftuar mbajtësin e certifikatës së regjistrimit;
- c) marrëveshja për t'u ndërlidhur me kontrollin e trafikut ajror;
- d) marrëveshja për të marrë pajisje dhe persona për të larguar avionët e paaftë, dhe
- e) emrat dhe rolet e personave përgjegjës për rregullimin e largimit të avionëve të paaftë dhe numrat e tyre të telefonit.

4.15 Trajtimi i materialit të rrezikshëm

Të dhënat e procedurave për trajtim dhe deponim të sigurt të materialit të rrezikshëm në aerodrom, duke përfshirë si në vijim:

- a) marrëveshja për zonat speciale në aerodrom që duhet të themelohen për deponim të lëngjeve që ndizen lehtë dhe ndonjë material tjetër të rrezikshëm, dhe
- b) metoda që duhet të përcillet për dorëzim, deponim, shpërndarje dhe trajtim të materialeve të rrezikshme.

4.16 Operimet në dukshmëri të ulët

- a) Të dhënat e procedurave që duhet të paraqiten për operimet në dukshmëri të ulët, duke përfshirë marrjen e masës dhe raportimin e kufirit vizual të pistës, dhe kur kërkohen emri dhe numrat e telefonit gjatë dhe pas orarit të punës të personave përgjegjës për matjen e kufirit vizual të pistës;

b) nëse veprimtaritë lejohen gjatë periudhave të dukshmërisë së ulët dhe procedurat për mbrojtjen e pistave gjatë periudhave të tilla.

4.17 Mbrojtja e radarit dhe e pikave të navigacionit

Të dhënat e procedurave për mbrojtjen e radarit dhe ndihmat e radionavigacionit të vendosura në aerodrom për të siguruar se performanca e tyre nuk do të pakësohet, duke përfshirë si në vijim:

- a) marrëveshja për kontrollin e aktiviteteve në afërsi të radarit dhe pajisjeve të instaluar të NAVAIDS-it;
- b) marrëveshja për mirëmbajtjen e tokës në afërsi të këtyre pajisjeve të instaluar; dhe
- c) furnizimi dhe pajisjet e instaluar të shenjave që paralajmërojnë për rrezatimin e mikrovalëve të rrezikshme.

Pjesa 5

Administrimi i aerodromit dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë

5.1 Administrimi i aerodromit

Të dhënat e administrimit të aerodromit, duke përfshirë si në vijim:

- a) diagrami i strukturës organizative të aerodromit, duke treguar emrat dhe pozitat e personelit kyç, duke përfshirë edhe përgjegjësitë e tyre;
- b) emri, pozita dhe numrat e telefonit të personit që ka përgjegjësi të përgjithshme të sigurisë së aerodromit; dhe
- c) komitetet e aerodromit.

5.2 Sistemi i menaxhimit të sigurisë (SMS)

Sistemi i menaxhimit të sigurisë, që është themeluar për të ofruar përputhje me të gjitha kushtet e sigurisë dhe për arritje të vazhdueshme të përmirësimit në performancën e sigurisë, duke pasur veçoritë kryesore:

- a) politika e sigurisë deri në shkallën e zbatueshmërisë, në proces të menaxhimit të sigurisë dhe raportit të saj me procesin operativ dhe të mirëmbajtjes;
- b) struktura apo organizimi i SMS-së, duke përfshirë plotësimin me personel dhe caktimin e përgjegjësive individuale apo grupore të çështjeve të sigurisë;
- c) strategjia e SMS-së dhe planifikimi, siç është vendosja e caqeve të performancës së sigurisë, duke i ndarë prioritetet për zbatimin e iniciativave të

sigurisë dhe ofrimit të një kornize për kontrollimin e rreziqeve deri në atë nivel që është sa më i ulët në zbatueshmëri, që gjithmonë duke i pasur parasysh kushtet e standardit dhe praktikat e rekomanduara në Aneksin 14, Volumi 1 i Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe rregulloret nacionale, standardet, rregullat apo urdhrat;

d) zbatimi i SMS-së duke përfshirë objektet, mënyrat dhe procedurat për një komunikim efektiv të mesazheve të sigurisë dhe zbatim të kushteve të sigurisë;

e) sistemi për zbatimin dhe veprimin në zonat kritike të sigurisë, të cilat kërkojnë nivel më të lartë të integritetit për menaxhimin e sigurisë (Programi për Masat e Sigurisë);

f) masat për avancimin e sigurisë, parandalimi i aksidentit dhe sistemi për kontroll të rrezikut, duke përfshirë edhe analizën dhe trajtimin e aksidentit, incidenteve, defekteve, gabimeve, mospërputhjeve dhe dështimeve, dhe vazhdimi i monitorimit të sigurisë;

g) auditimi i sigurisë së brendshme dhe sistemi i rishikimit që japin në hollësi sistemet dhe programet për kontrollin e cilësisë së sigurisë;

h) sistemi për dokumentimin e të gjitha objekteve që kanë të bëjnë me sigurinë e aerodromit, si dhe shënimet e mirëmbajtjes dhe operimeve të aerodromit, duke përfshirë informatat në përpunim dhe ndërtim të shtresimit për avion dhe ndriçim të aerodromit. Sistemi duhet të mundësojë rikthim të lehtë të shënimeve që përfshijnë diagramet;

i) trajnimi i personelit dhe kompetencat, duke përfshirë rishikimin dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së trajnimit të ofruar për personel për detyrat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe të sistemit certifikues për testimin e kompetencës së tyre; dhe

j) përfshirja e klauzolave në lidhje me sigurinë në kontrata të punës në aerodrom dhe zbatimi i tyre.